



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

EC MA NDARYSHE

THIRRJE PËR OFERTË

Hartim/zhvillim i manualit për promovimin, vullnetarizmin dhe përfshirjen e të drejtave mjedisore dhe të drejtave të njeriut në iniciativat rinore

Programi për të drejtat e njeriut, "HumanRigtivism", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për "Hartim/zhvillim i manualit për promovimin, vullnetarizmin dhe përfshirjen e të drejtave mjedisore dhe të drejtave të njeriut në iniciativat rinore".

Dokumenti duhet të ofrojë një udhërrëfyes strategjik që përshkruan hapa dhe mekanizma praktikë për aktivizimin mjedisor të të rinjëve dhe për promovimin, vullnetarizmin dhe përfshirjen e të drejtave mjedisore dhe të drejtave të njeriut në iniciativat rinore.

Dokumenti duhet të ofrojë një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara në kuadër të projektit dhe në të njëjtën kohë të ofroj një analizë mbi impaktin pozitiv dhe negativ që këto aktivitete kanë pasur në komunitet. Ndër të tjera ky dokument duhet të përmbajë edhe të dhëna dhe shembuj konkret nga vendi, rajoni dhe Evropa mbi përfshirjen dhe aktivizimin e të rinjëve për vullnetarizimin, mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit dhe promovimin e të drejtave të njeriut specifikisht atyre mjedisore.

Gjatë hartimit/zhvillimit të dokumentit, pala e angazhuar duhet të organizoj takime me përfaqësues të stafit për të diskutuar mbi aktivitetet që janë realizuar në kuadër të projektit, duhet të shfrytëzoj materialet dhe dokumentet e prodhuara në kuadër të projektit dhe të organizoj sipas nevojës dhe takime me të rinjë që kanë qenë pjesë e aktiviteteve të realizuara.

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH- së (kompanitëqë janë deklaruese të TVSH-së), CV-të e personave që do të angazhohen për realizimin e aktivitetit;
- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të metodologjisë së hulumtimit/analizës duke ofruarsë paku informata mbi dokumentacionin që do të analizohet, palët që do të përfshihen/kontaktohen dhe strukturën e propozuar të dokumentit. Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyrë të EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më 27.10.2023 ,ora 15:00 me shënim: *“Hartim/zhvillim i manualit për promovimin, vullnetarizimin dhe përfshirjen e të drejtave mjedisore dhe të drejtave të njeriut në iniciativat rinore”*. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: info@ecmandryshe.org deri më 25.10.2023.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm ekspertët /grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të fitues do të informohen/kontaktohen.